

Nuk është ndonjë gjë e madhe!



A e dini se?

Dritani: Si ndjehesh sot, baba?

Gjergji: Nuk kam pse të ankojem. Kam ca dhimbje por jo si vitin e kaluar.

Dritani: Po, ne u shqetësuam për ty për shkak të kancerit të prostatës.

Gjergji: Edhe unë u shqetësova. Por ju të gjithë vërtet më ndihmuat që ta kaloj atë vështirësi.

Dritani: A e di baba, gjithçka që kalove ti më bëri që të mendohem sepse jam 44 vjeç dhe kam familje për të cilën duhet të kujdesem.

Kështu që shkova te mjeku dhe fola me të për kancerin e prostatës dhe bërjen e analizës që ta zbulojmë shpejt. Ai më shpjegoi avantazhet dhe disavantazhet e analizës dhe më pyeti se çfarë doja të bëja.

Gjergji: Çfarë bëre?

Dritani: Vendosa që ta bëj analizën. U çlirova mjaft kur mora vesh që jam në rregull.

Gjergji: Jam krenar për ty, biri im. Por tani kemi një detyrë të madhe përpara që t'i mbushim mendjen vëllezërve të tu që të flasin me mjekët e tyre.

Dritani: Meqenëse kanceri i prostatës është shfaqur në familjen tonë, ata duhet të flasin me mjekët e tyre që në moshën 45 vjeç.

Mjeku më tha se në qoftë se nuk është shfaqur në familje, mund të presësh deri në moshën 50 vjeç.

Gjergji: Këshillë të mirë të ka dhënë. Eja të shkojmë dhe të flasim me vëllezërit e tu për këtë.

- Analiza e kancerit të prostatës bëhet së bashku me një analizë PSA ose kontroll të zorrës së drejtë.
- PSA do të thotë “antigjen specifik i prostatës” dhe është analizë gjaku.
- Njëpërmjet kontrollit të zorrës së drejtë mjeku prek gjëndrën e prostatës.
- Shumica e burrave duhet të flasin me mjekët e tyre për kancerin e prostatës duke filluar në moshën 50 vjeç.
- Burrat afrikano-amerikanë dhe burrat që vijnë nga familje në të cilën është shfaqur kanceri i prostatës duhet të flasin me mjekun duke filluar në moshën 45 vjeç.
- Burrat duhet të vendosin nëse analiza është zgjedhja më e mirë për ta pasi të kenë mësuar avantazhet dhe disavantazhet e analizës.

Për të marrë faktet për kancerin e prostatës, telefononi:

1.800.227.2345



Get help anytime.

1.800.ACS.2345 / www.cancer.org